



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 3134/2 prot.

Pogradec, më 15.07 2021

**VENDIM**

**NR. 68 , DATË 14 . 07 . 2021**

**PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DHE THEMELIMIN E OJF  
PËR ZHVILLIMIN E EKO-TURIZMIT NË ZONËN  
DRILON – TUSHEMISHT**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja b, pika 1.6, shkronja a,b, neni 23 pika 14, neni 54, neni 55, të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ndryshuar, neni 5 pika 1.3, të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, ligjit Nr. 8788, 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, vendimit Nr. 40, datë 06.05.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec, të disa pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim (AADF) “Për realizimin e projektit Drilon – Tushemisht”, krijimin dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Pogradec në organizatën jofitimprurëse Qendrës “Parku Ujor Drilon Tushemisht” dhe miratimin e akteve të themelimit me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Miratimin për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e projektit Drilon - Tushemisht midis Bashkisë Pogradec dhe, Fondacionit Shqiptaro - Amerikan për Zhvillim (AADF) sipas tekstit të projekt - marrëveshjes bashkëlidhur.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit ka si objekt zbatimin e Projektit për zhvillimin e Eko-Turizmit në zonën Drilon – Tushemisht. Projekti synon të kthejë fshatrat Tushemisht dhe Drilon në një destinacion turistik i cili ofron aktivitete të larmishme dhe të diversifikuara dhe sipas një modeli të qëndrueshëm. Objektivi i projektit është të nxisë rritjen e kapaciteteve turistike dhe nivelin e shërbimeve të ofruara, duke synuar zgjerimin e larmisë së aktiviteteve turistike, në të gjithë territorin e zonës së Projektit, pa qëllime fitimi dhe në interesin më të mirë të përbashkët të Zonës së Projektit.
3. Miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Pogradec, në cilësinë e subjektit bashkëthemelues i organizatës jofitimprurëse Qendrës “Parku Ujor Drilon Tushemisht”, së bashku me subjektin tjetër bashkëthemelues, në cilësinë e Donatorit, Fondacionin Shqiptaro - Amerikan Për Zhvillim

- Albanian- *American Development Foundation*. Të drejtat dhe detyrimet, si edhe kushtet e pjesëmarrjes së Bashkisë Pogradec në Qendrën “Parku Ujor Drilon Tushemisht”, rregullohen sipas Akt Themelimit dhe Statutit të OJF, sipas tekstit të Akt Themelimit dhe Statutit të OJF bashkëlidhur.

4. Qendra “Parku Ujor Drilon Tushemisht”, do të ketë si qëllim kryesor të saj realizimin e Projektit për zhvillimin e Eko-Turizmit në zonën Drilon – Tushemisht, bazuar në shprehjen e interesit dhe kërkesën e Bashkisë Pogradec, sipas propozimit të Donatorit dhe dakordësisë midis Bashkisë Pogradec dhe Donatorit. Veprimtaria e qendrës nuk do të ketë në asnjë rast apo rrethanë qëllim fitimi dhe zhvillohet vetëm në interes të komunitetit dhe territorit, për qëllim realizimin e veprimtarive të objektit të saj.

5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec, si autoriteti përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit të saj administrativ për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

